

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“Amar Tools Albania “ shpk

Në Tiranë, sot më datë 01.06.2023, ne të poshtëshënuarit:

- 1- Ervin Nushi, i datëlindjes 30.06.1988, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal I80630002Q.
- 2- Taulant Guçe, i datëlindjes 29.04.1993, lindur në Pogradec dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal J30429024I.
- 3- Izmir Brika, i datëlindjes 26.03.1987, lindur në Bulqize dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal I70326094T.

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**Amar Tools Albania “ shpk,**

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “**Amar Tools Albania**”, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Tirane, Njesia Administrative Vaqarr, Objekt ne zonen kadastrale 3712, me nr. Pasurie 301/10.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Tregti me shumice dhe pakice te materialeve industriale, tregti me shumice dhe pakice te veglave te punes, tregti me shumice dhe pakice te veglave buqesore dhe pjeseve te ndryshme te tyre, tregti me shumice dhe pakice te materialeve elektrike, tregti me shumice dhe pakice te materialeve hidraulike.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë është 100000 lekë, i ndarë në tre kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

Ervin Nushi, zotëron 1 kuotë me vlerë 20000 lekë, e cila përbën 20% të kapitalit të shoqërisë.

Taulant Guçe, zotëron 1 kuotë me vlerë 28000 lekë, e cila përbën 28% të kapitalit të shoqërisë.

Izmir Brika, zotëron 1 kuotë me vlerë 52000 lekë, e cila përbën 52% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administratorë të shoqërisë janë:

- Ervin Nushi, i datëlindjes 30.06.1988, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal I80630002Q, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.


Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "Amar Tools Albania " shpk , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKËT THEMELUES

IZMIR BRIKA

Handwritten signature of Izmir Brika in blue ink, featuring a stylized, angular script.

Ervin

Handwritten signature of Ervin in blue ink, with a cursive style and a horizontal line underneath.

Taulant Guxer

Handwritten signature of Taulant Guxer in blue ink, with a cursive style and a long horizontal line extending to the right.